



Statusi i ilmul kelamit në Islam

Description

Hasan Mahmud esh-Shafii

Fragment i shkëputur nga libri i Hasan esh-Shafii me titull “El-Medkhal ila Diraseh Ilmul Kelam”, Mektebeh Uehbeh, botimi i dytë, Kajro 1991, f. 35-48

Ilmul kelami është ajo dije shariatike e cila ka si synim “*studimin e gjykimeve besimore në shariatin islam*”. Ky është një qëllim fisnik dhe i rëndësishëm, por që nga koha e mëvetësimit të kësaj dije si një disiplinë në vete janë shfaqur shumë grupacione dhe janë ndeshur shumë mendime. Në historinë e gjatë të civilizimit islam rreth kësaj çështjeje janë shkruar shumë libra dhe kanë lindur shumë medhhebe, prej të cilave disa ishin më afër e disa më larg besimit të pastër islam, ashtu siç është transmetuar ajo në Kuran dhe në traditën profetike. Dijetarët e kësaj discipline shpesh kanë përdorur metodologji të cilat jo gjithnjë kanë qenë në përputhje të plotë me epistemologjinë (*usulu nedhri*) dhe mënyrën e argumentimit kuranor. Çështja rreth kësaj dijeje evoluoi në mënyrë të tillë sa që shpesh në grupacionet e kelamit gjejmë ekstremizma të tillë sa që gati nuk bëhen shkak që ata të dalinkrejtësisht nga mileti mysliman. Po ashtu, në të gjemë grupacione që tejkalojnë çdo kufi duke ndërtuar medhhebe të huaja për Islamin dhe mendime të çuditshme që arritën deri në përzierien e shqyrtimeverrethakides [besimit islam] me filozofi me bazë pagane, qofshin këto të lindjes apo perëndimit.

Si pasojë e kësaj që sapo thamë, në ambientin islam u shfaqën zëra të cilët vunë në dyshim legjitimitetin e kësaj dijeje dhe disa prej tyre bënë thirrje për braktisjen e kësaj discipline, ndalimin e leximit të librave të kelamit, njohjen me grupet e tyre apo pjesëmarrjet në grumbullimet e tyre. Këto opinione kritike mbështeten tek tekste të ndryshme të transmetuara nga profeti (a.s.), të cilat ndalojnë “kelamin” [diskutimin] në fe apo polemikat në akide. Këto mendime kanë marrë forcë, përveç teksteve fetare, edhe nga disa fenomene negative të shfaqura gjatë periudhës së mesme të historisë së shkencës së ilmul kelamit, të tilla si neglizhenca e argumenteve tradicionale, nxjerrja prej feje (tekfir) e armiqve të tyre apo përdorimi i logjikës greke apo e ndonjë sistemi tjetër logjik. Këto mendime kritike u rritën derisa u shndërruan në rryma të qarta dhe qasje të spikatura në etapat pasuese të mendimit islam.

1. Fillimet e kësaj tendence shfaqen në ato thënie kritike ndaj ilmul kelamit që i vishenthemeluesve të katër shkollave juridike islame. Ibn Tejmija ka raportuar një sërë thëniesh të tillanë librin e tij “Dari tearud akli ue nakl”. [1]
2. Kjo qasje kritike ndaj disiplinës së ilmul kelamit u përvetësua edhe nga një sërë muhadithësh dhe hafëzësh prej dijetarëve selef, të cilët i frikësoheshin rreziqeve që përmbante kjo disiplinë ndaj bashkësisë myslimane [umet] dhe për pasojë e ndaluan këtë dije në tërësinë e saj si edhe mosaprovuan atë pa u zgatur shumë, siç ishte rasti i Khatabit në librin e tij “El-Gunje” dhe i Kutejbes në librin e tij “Teuil mukh’teleful hadith”. Shumicën e këtyre thënieve e ka mbledhur Heravi në veprën e tij “Dhemul Kelam”. [2]
3. Po ashtu të njëjtën qëndrim mbajtën edhe një grup dijetarësh, midis të cilëve gjendeshin muhadith dhe sufinj të ndryshëm. Madje edhe vetë midis kelamistëve pati një grup që njohën rreziqet që përmbante kelami dhe urryen gjithçka që vinte prej tij, përveç asaj që gjendet në Kuran dhe në traditën profetike. Një rast i tillë ishte edhe ai i Ibn Tejmijes në shumicën e librave të tij dhe veçanërisht në librin “Dar’i tearud el-akli ue nakl”, rasti i Gazaliut në shumicën e librave të tij dhe veçanërisht në esenë e tij “Ilxham el-Auam an ilmul Kelam”, apo si rasti i Ibn Vezirit në librin e tij “Terxhih esalib el-Kuran ala esaalibu junan”
4. Kjo traditë u shkri më pas tek Imam Sujutiu i cili përmbloodhi shumicën e saj në një nga librat e tij, titulli i të cilit shpreh njëkohësisht edhe mendimin e vetë autorit dhe tematikën që ai trajton. Libri në fjalë quhet “Saunul mantiki uel kelam an fenil mantiki uel kelam” (Mbrotja e logjikës dhe e fjalës nga disiplina e logjikës dhe fjalës), botim i së cilit është celebruar në Egjipt kohët e fundit.
5. Tendencë për ta sulmuar kelamin dhe për ta konsideruar atë si të ndaluar vazhdon edhe në kohën tonë. Ajo mund të shihet qartë në një sërë librash të shkruar nga i ndjeri Abdul Halim Mahmudi, veçanërisht në librin e tij me titull “El-Islam: uel Akl” (Islami dhe mendja). Po ashtu i njëjti fenomen haset edhe në parathënien që i ndjeri Mahmud Kasim ka shkruar për librin

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi